



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragash/Dragas Municipality

- Kuvendi Komunal
O1 Nr.463-643
Dt.03.05.2012
D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.03.05.2012, duke shqyrtuar Kërkesën e Drejtoratit të Urbanizmit, Katastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit (Shërbimit Pronësoro-Juridik të Komunës-Dragash) 01 Nr.463-643, lidhur me Kërkesën e z. Shaban Reka nga Restelica, për ndarje të trolit nga prona shoqërore për ndërtimin e shtëpisë për familjen e viktimizuar Reka, pas shqyrtimit paraprak të Raportit të Komisionit të KK-së, miraton këtë :

V E N D I M

- I. **OBLIGOHET** Drejtorati për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, përkatësisht Shërbimi Pronësoro-Juridik i këtij Drejtorati, që në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi të përfundon procedurën dhe lëshon Aktvendimin **për ndarjen e 180 m²** të trolit në pronën shoqërore, konform Kërkesës dhe listës poseduese 452, në vendin e qujtur "Priporishte", të ZK Restelica..
- II. Ky Vendim hynë në fuqi nga data e miratimit në Kuvendin Komunal të Dragashit.

Arsyetim

Kuvendi Komunal i Dragashit, në seancën e dt.03.05.2012, duke shqyrtuar Kërkesën e lartpërmendur të Drejtoratit dhe Raportin e Komisionit të themeluar nga Kuvendi Komunal vendos si në dispozitiv të pikës I të Vendimit, duke e pasur parasysh rastin specifik të familjes së viktimizuar Reka, pas rrëshqitjes së ortekut të borës dhe humbjes së 10 anëtarëve të kësaj familjeje.

I dërgohet:

- Drejtoratit për Urbanizëm, Katastër dhe Mbrojtje të Mjedisit të KK-së, drejtorit Bean Haxhihasan,
- Shërbimit Pronësoro-Juridik të këtij Drejtorati të KK-së, shefit Ramadan Krasniqi,
- z. Shaban Reka-Restelicë, dhe
- Arkivit

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH



Kryesuesi
Lulzim Rifaj